

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008 dhe nenit 14 të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2021, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR VENDOSJEN E SHTATOREVE PËR DËSHMORËT DHE VEPRIMTARIN E KOMBIT

Neni 1

MIRATOHET, Vendimi për caktimin e tri (3) lokacioneve për vendosjen e tri (3) shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit si vijon:

1. Lokacioni 1 -Shtatorja e dëshmorit të kombit "Xhavit Kozhani" përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409044-01792-4, ZK Lipjan që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër në vendin e quajtur "Varosh".
2. Lokacioni i dytë – Shtatorja e dëshmorit të kombit "Haradin Bajrami" përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409080-00362-0 ZK Grackë e vjetër që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër, në vendin e quajtur "Progon".
3. Lokacioni 3-Shtatorja e veprimtarit të kombit "Ruzhdi Shabani" përcaktohet në pjesën e parcelës kadastrale në pronësi shoqërore P-71409044-01637-0 në ZK Lipjan në vendin e quajtur "Varosh" që shtrihet në rrugën "Avdi Kelmendi".

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjedzezi dhe Kadastër, Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008 dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike 15Nr.011-5823 të datës 01.02.2016.

Drejtorati për Planifikim ,Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me shkresën nr 8-450-8403 të datës 15.02.2021 i ka propozuar Kryetarit të Komunës tri lokacionet e mundshme për vendosjen e shtatoreve të dëshmorëve dhe veprimtarit të kombit siq ceket në nenin 1 të këtij Propozimi Vendimi.

Vendosja e shtatoreve në lokacionet e cekura bëhet me qëllim të nderimit të veprës së tyre .

Në shtesë të këtij Propozim-Vendimi ju bashkëngjesim një biografi të dëshmorëve dhe veprimtarit të kombit të cekur në nenin 1 të këtij Propozim-Vendimi.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 353 - 11384

Datë 26.02.2021






Xhavit Kozhani "Burgija", Dëshmor i Kombit (1966-1999)

U lind më 19 mars të vitit 1966 në Ribar i Madh, nga prindërit, Ragipi dhe Mirishahja, të cilët kishin 6 fëmijë, tre djemë e tri vajza. Ragip Kozhani, ishte minator i Minierës së Magnezitit Golesh, në Magurë. Xhaviti, shkollën fillore e kreu në Ribar, ndërsa të mesmën, drejtimin e xehtarisë e përfundoi në Lipjan. Për ta ndihmuar familjen, shkoi për të punuar në Kroaci, në qytetin e Pazinit, si puntor krahut. Pas dy viteve të qëndrimit atje, kthehet në Kosovë. Inkuadrohet në minierën e Goleshit dhe aty punon deri në vitin 1990. Pas grevave të minatorëve dhe grevës së përgjithshme të 3 shtatorit të vitit 1990, gati të gjithë të punsuarit shqiptarë në Kosovë u larguan nga vendet e tyre të punës. Nga mbi 1200 të punësuarit shqiptarë të larguar në minierën e Goleshit, në mesin e tyre ishte edhe Xhavit Kozhani. Familja Kozhani, e posaqërisht Xhaviti, e kishte të ngritur ndjenjën kombëtare, që nga fëmijëria, pasi mixha i tij, Ibrahim Kozhani qysh herët në vitin 1963 ishte dënuar me 4 vite burg për shkak të veprimtarisë së tij politike, kombëtare, për flamur e të drejta për shqiptarët, bashkë me një grup të idealit, nga Lipjani e Prishtina, të quajtur "Organizta nacionalë". Xhaviti ishte i martuar me Feride Osmanin ku iu lindën dy vajza (Arbnora dhe Mirishaha) dhe dy djemë (Qëndrimi dhe Shkelqimi).

Në maj të vitit 1998 iu bashkohët radhëve të UÇK-së në Llapushnik. Më vonë transferohët në Brigadën 121, "Ismet Jashari-Kumanova", Batalioni "Imer Alushani". Xhaviti, me nofkën "Burgia", mori pjesë në shumë akione të organizuara kundër njësive polikore dhe ushtarakë serbe. Ushtria serbe kishte marrë ofanzivën për ti marrë vijat Prishtinë-Pejë dhe Shtime-Duhel - Prizren. Në betejën e Grykës së Llapushnikut, ku ushtria serbe kishte koncentruar të gjitha forcat për të depërtuar vijën rrugore, më 23 dhe 24 gusht 1998, Xhaviti me shumë luftarë u ballafaqua në atë betejë. Më 25 gusht, armiku kishte angazhuar forca shtesë për ta hapur vijën Llapushnik-Gryka e Carralevës. Xhaviti me shokë e bënte evakuimin e popullatës në zonat më të sigurta të maleve të Berishës. Nga 15 shkurti 1999, ishte komandant skuadre në Batalionin "Imer Alushani", në Kizharet. Mori pjesë në sulmin diverzant ndaj konvojit të Policsë në aksin Magurë-Blinajë. Gjatë sulmeve të NATO-s, mbi caqet serbe, Xhaviti ishte i vendosur te "Guri i Gradines", si përforcim për ti mbrojtur popullatën e strehuar.


Më 26 maj 1999, forcat serbe kishin sulmuan fshatin Ribar i Madh, popullata kishte ikur nga fshati dhe ishte strehuar në Blinajë. Xhaviti ishte në mesin e banorëve. Ai strehon një grup të rinjëve dhe i nxjerr nga rrëthimi. Vëzhgon terenin përballë forcave armike. Vërehët nga snajperistët serbë dhe bie në altarin e lirisë, duke bërë rezistencë me këto forca armike. Pas luftës është shpallë dëshmor i kombit. Për ndër të dëshmorit, në fshatin Ribar i Madh, është ngritur përmendorja e ketij trimi, që i bënë fshatit drite lirie.



Haradin Bajrami "Dinamiti" (1862-1999)

U lind më 12 shkurt 1962 në fshatin Leletiq të komunës së Lipjanit, nga prindërit Asllani dhe Sadija, të cilët gjatë jetës bashkëshortore i kishin 11 fëmijë, shtatë vajza dhe katër djemë. Babë Asllani ishte lufëtar i denjë i rezistencës kombtare për trojet etnike. Hajredini shkollën fillore e kreua në Magurë, ndërsa ate të mesmën në Lipjan. I frymëzuar nga prindi, i cili djemëve ua kishte lënë amanet pushkën e vet, të fshehur në mur, si nxënës ishte pjesëmarrës i demonstrative të vitit 1981, në Lipjan dhe Prishtinë. Në aktivitetin e tij, kishte shpërndarë afishe në rrugën Magurë-Lipjan dhe më 1984, ishte dënuar nga Gjykata me 60 ditë burg, të cilin e kishte vuajtur në burgun e Gjurakovcit. Kishte mjeshtri gdhendjën e gurit dhe me këtë zeje siguronte familjen. Ishte martuar në vitin 1986 me Rukije Sahitin dhe në martesë i kishte pesë fëmijë, katër djemë (Sabedini, Liridoni, Dardani dhe Perparimi) dhe vajzën Fatlinden.

Me daljën në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hajredin Bajrami, së bashku me vëllaun Rexhepin ishin kyçur menjëherë në radhët e UÇK-së. Për të qenë më të sigurtë gjatë bartjës së ndihmave për zonën e luftës, Hajredini, me nofkën "Dinamiti", së bashku me shokë kishte bërë një lidhje të fshatrave Vërshevc-Leletiq me malin e Blinajës, ku më lehtë depërtionin ndihmat për Shalë, Krojmir e Kleçkë, ku vepronin njësitë e UÇK-së. Ai së bashku me shokë të tjera bënte ngritjen e istikameve, përgjatë rrethit të Blinajës dhe në Leletiq. Kryente detyrat që i besoheshin. Pas ofanzivës së verës, më 23 gusht 1998, të ndërmarrë nga ushtria dhe policia serbe, Hajredini iu bashkohët shokëve në Shalë, por duke mos u larguar nga vëzhgimi në Blinajë, detyrë të cilën e kryente me sukses. Ai mori pjesë në akcionet luftarake në Blinajë, Komoran dhe vendet tjera. Në shtator të vitit 1998, bashkë me një grup shokësh luftëtar, sulmojnë një patrullë policie brenda në Blinajë. Ishte i caktuar komandant i toges në pikë Blinajë-Mirenë. Gjatë vëzhgimit, të cilën detyrë e kishte gjatë ofanzives serbe te marsit dhe prillit, më 2 prill 1999 në Blinajë te vendi i quajtur "Ligata e Madhe", aty kah mesdiata, bie në fushën e minuar të armikut dhe plagoset rëndë, bashkë me ushtarin Driton Grantolli nga Shala. Bashkëluftarët e tij, bëjnë të pamundurën që ta shpëtojnë, duke e dërguar në Ambulancë Ushatrake në Shalë, por nuk mund të iu përballon plagëve të rënda. Varroset nga njësitë e luftëtarëve, me nderime ushtarake. Trupi i tij pushon në Varrezat e Dëshmorëve në Kleçkë. Hajredin Bajrami, është shpallë Dëshmor i kombit. Me emërin e dëshmorit, është emërtuar shkolla fillore e Magurës. Për nder të veprës së tij edhe një rrugë në Lipjan është emërtuar "Hajredin Bajrami". Në hyrje të fshatit Leletiq, i është ngritur Lapidari.



Ruzhdi Shabani, veprimtar dhe humanist (1935-2007)

U lind në Poturovc të Lipjanit, më 20.10.1935, në një familje atdhetare, gjyshi Brahimi ishte ekzekutuar më 1913 nga fashistët bulgarë dhe regjimi serbë. Babai i Ruzhdiut, Latifi, ishte atdhetar dhe antarë NDSH-së, pjesëmarrës i Takimit të "Mulliri i Qylagës", që ishte parapërgaditje e Kongresit të Pestë të Blinajës, mbajtur më 25 Korrik 1946. Vyrtytet patriotike dhe humanitare i kishte të trashëguara Ruzhdiu. Në moshë të re është detyruar të punësohët në Minierën e Magnezitit "Golesh", me që pushteti serb iu kishte konfiskuar një sasi të madhe të tokës së punës. Në vitet e 80-ta, vëllëzërit Shabani ndërtojnë në Poturovc një mulli elektrik. Humanizmi i kryefamiljarit, Bacës Ruzhdi, mullirin e kthen në magje të nevojtarëve. Ai thonte: "Bamirsia është gjithëfare, por me bukë nuk ka lojë". Gjatë ngujimit të minatorëve të kombinatit "Trepça" dhe minierave tjera, më 1989, mielli nga mulliri i kësaj familje, ka arritur në gati në çdo familje nevojtare të këtyre minatorëve. Gjatë luftës në Kosovë, kjo familje ka dërguar miell për mijëra të strehuar në malet e Drenicës dhe Grykat e këtyre fshatrave. Duke u rënë në sy okupatorit serb këto aktivitete nga mulliri në Poturovc, policia serbe bashkë me paramilitarë, më 24.08.1998 e mësyen Poturovcin dhe dogjën mullijtë bashkë me mbi 300.000 kg grurë dhe miell në depo.

Aktiviteti i këtij trimi, pajtuesi të gjaqeve, humanisti, aktivistit politik dhe kryefamiljarit të zellshëm, ishte i shtrirë në shumë fusha. Gjatë ndryshimeve kushtetuese, ishte në ballë të kundërshtimeve bashkë me rininë shqiptare, Ishte antar i Këshillit Komunal për Financim (KKF), nga 1993-1999. Për të ndihmuar nxënësit e Poturoycit, ishte nismëtar i ndërtimit të shkollës katërvjeçare në fshat. Mbrojti shkollën shqipe dhe mori pjesë aktive në të gjitha protestat dhe demonstratat e organizuara në at kohë. Bashkë me Avdi Kelmendin, djemë e vasha të reja kosovare, ishte në ballë të akcionit për pajtimin e gjaqeve. Shumë herë oda e bacës Ruzhdi, ishte vendtakim i këtyre organizimeve. Në odën e tij mbaheshin takime të partive politike shqiptare, të shoqatës "Nëna Tereze" dhe takime tjera që organizoheshin me qëllim të rezistencës dhe luftës për liri.

Ruzhdi Shabani, ishte Deputet i Parlamentit të Kosovës gjatë mandatit sa ishte antar i Partisë Fshatave të Kosovës (PFK), pas Zgjedhjeve të para të Parlamentit të Kosovës, më 1992. Ky ishte një bujk i vyshtë, në mesin e intelektualëve. Nga eksperiencia jetësore e Bacë Ruzhdiut, mësuam shumë, ai thoshte: "Njeriu vlenë sa ta pranojnë të tjerët", "Nuk duhet të jetojmë kot, njeriu ka mision". Kur rebelohej nga dhuna serbe dhe përdhosja kombëtare, thoshte: "E kemi liruar tepër pambukun, kështu ma nuk durohet", "Sakica në vend të huej nuk e pret as kungullin, ndërsa në vend të vet e pret edhe hekurin"...

Ruzhdi Shabani ndrroi jetë më 9.04.2007, pas një sëmundje të rëndë. Pas vehtës la familjen si dhe vepra të mëdha atdhetare e humaniste, të cilat do të kujtohën përjetësisht.



R E P U B L I K A E K O S O V È S

KOMUNA E LIPJANIT

Datë :	15.02.2021
Referencë :	8450-8403
Për :	Zyra e Kryetarit të komunës Imri Ahmeti -Kryetar i komunës
Përmes:	z.Emine Rexhiq-Drejtori i DPUMM
Nga:	Bajram Sinani-Nëpunës për Urbanizmën në Komunën e Lipjanit
Lënda :	Përcaktimi i lokacioneve për shtatoret e dëshmorëve dhe veprimitarëve të kombit.


Duke u bazuar në dërgesën në kompetencë 8-463-8403 e drejtuar nga Zyra e Kryetarit lidhur me kërkesën për përcaktimi i lokacioneve për shtatoret e dëshmorëve dhe veprimitarëve të kombit DPUMM ju informon se:

Janë përcaktuar lokacionet në të cilat do të vendosen shtatoret dhe janë sinë vazhdim

1. Lokacioni 1 –Shtatorja e heroit të kombit dëshmori Xhavit Kozhani është përcaktuar në lokacionin ,parcela P-01792-4 ZK Lipjan, që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër.
2. Lokacioni 2 –Shtatorja e heroit të kombit dëshmori Haradin Bajrami është përcaktuar në lokacionin ,parcela P-00362-0 ZK Grackë e Vjetër, që shtrihet në rrugën me të njëjtin emër.
3. Lokacioni 3 –Shtatorja e heroit të kombit veprimitari Ruzhdi Shabani është përcaktuar në lokacionin ,parcela P-01637-0 ZK Lipjan, që shtrihet në rrugën “Avdi Kelmendi”.

Arsyetim: Lokacionet janë përcaktuar në bazë të lidhjes që kanë emrat e rrugëve dhe vendosja e shtatoreve, si dhe duke u bazuar në hapësirat dhe parcelat që posedon Komuna e Lipjanit të evidentuar si pronë publike.

Skicat nga PZHU.



Parcela P-01792-4, ZK Lipjan Rr. "Xhavit Kozhani" lokacioni
për vendosjen e shtores të dëshmorit të kombit Xhavit
Kozhani"

1

P-71409044-01252-1

P-71409044-01253-16

P-71409044-01252-17

P-71409044-01253-1030

P-71409044-01252-1

P-71409044-01253-2

P-71409044-01259-1

P-71409044-01259-2

P-71409044-01259-3

P-71409044-01259-4

P-71409044-01259-5

P-71409044-01259-6

P-71409044-01259-7

P-71409044-01259-8

P-71409044-01259-9

P-71409044-01259-10

P-71409044-01259-11

P-71409044-01259-12

P-71409044-01259-13

P-71409044-01259-14

P-71409044-01259-15

P-71409044-01259-16

P-71409044-01259-17

P-71409044-01259-18

P-71409044-01259-19

P-71409044-01259-20

P-71409044-01259-21

P-71409044-01259-22

P-71409044-01259-23

P-71409044-01259-24

P-71409044-01259-25

P-71409044-01259-26

P-71409044-01259-27

P-71409044-01259-28

P-71409044-01259-29

P-71409044-01259-30

P-71409044-01259-31

P-71409044-01259-32

P-71409044-01259-33

P-71409044-01259-34

P-71409044-01259-35

P-71409044-01259-36

P-71409044-01259-37

P-71409044-01259-38

P-71409044-01259-39

P-71409044-01259-40

P-71409044-01259-41

P-71409044-01259-42

P-71409044-01259-43

P-71409044-01259-44

P-71409044-01259-45

P-71409044-01259-46

P-71409044-01259-47

P-71409044-01259-48

P-71409044-01259-49

P-71409044-01259-50

P-71409044-01259-51

P-71409044-01259-52

P-71409044-01259-53

P-71409044-01259-54

P-71409044-01259-55

P-71409044-01259-56

P-71409044-01259-57

P-71409044-01259-58

P-71409044-01259-59

P-71409044-01259-60

P-71409044-01259-61

P-71409044-01259-62

P-71409044-01259-63


P-71409044-01259-64

P-71409044-01259-65

P-71409044-01259-66


Parcela P-00362-0Zk Grackë e Vjetër, Rr." Haradin Bajrami"

Lokacioni përvendosjen e shtatores së dëshmorit të kombit Haradin Bajrami.



Parcela P-01637-0 ZK Lipjan, rr. "Avdi Kelmendi" -Lokacion ku mund të vendosen si ne piketimet ne harte.

Lokacionet e mundshme të vendoset shtatorja e vepriartit të kombit Ruzhdhi Shabani.



A screenshot of the Kosovo Cadastre software interface. The main window displays a satellite map of a rural area with numerous green-outlined land parcels. Some parcels are highlighted in red, indicating selected or edited areas. The map includes roads, a bridge, and some buildings. The software has a standard Windows-style toolbar at the top and bottom. On the left, there's a vertical sidebar with various icons and dropdown menus. The central part of the screen shows a detailed view of the land parcels with their respective numbers labeled on the map. At the bottom, there's a data entry form with fields for address, cadastral number, and other details. The title bar reads "Harta Kadastrale e Kosovës - Menaxhim i proceseve | Përdoruesi: Ramadani Hoxha".